



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK FIER
KRYESIA

Nr.

Fier në 25.07.2025

VENDIM NR. DATË

PËR MIRATIMIN E RENDIT PARAPRAK TË DITËS PËR MBLEDHJEN E DATËS

Kryesia e Këshillit Bashkiak Fier në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 27 datë 15.04.2020 "Për miratimin e rregullores së Këshillit Bashkiak, rregullores për Konsultimet Publike dhe Kodin e Sjelles për funksionimin e Këshillit", Kreu 2, neni 22 "Kryesia e Këshillit " neni 1, 3, 4

VENDOSI:

1-Miratimin e Rendit paraparak të Ditës për mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak, e cila do të zhvillohet në datën **31.07.2025 ora: 10:00** .Bashkëlidhur këtij vendimi gjenden pikat e Rendit paraparak të Ditës.

2-Ngarkohet Sekretari i Këshillit Bashkiak për publikimin e njoftimit të Rendit të Ditës, si dhe njoftimin e Këshilltarëve, Kryetarit të Bashkisë dhe çdo personi tjetër të interesuar për pjesëmarrje në mbledhjen e Këshillit Bashkiak.

3-Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYESIA E KËSHILLIT

1-Antoneta Çunaj

2-Arben Cuko

3-Fatbardha Merkaj

4-Evis Sema

5-Kreshqik Dapi

6-Endri Jaupaj

7-Rrapi Gjika



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË FIER

Nr. 8784 Prot.

Fier, më 25.07.2025

Lënda: Njoftim mbi zhvillimin e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak

Drejtuar: ANËTARËVE TË KËSHILLIT BASHKIAK FIER

Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË FIER
PREFEKTIT TË QARKUT FIER

Në mbështetje të nenit 53 pika 4, nenit 56 pika 2, shkronja "a", të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, ju njoftojmë thirrjen e mbledhjes së radhës së Këshillit Bashkiak Fier në sallën e këshillit ditën e **Enjte datë 31.07.2025 në orën 10:00** me këtë rend dite:

1. Miratimi i Rendit të Ditës.
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë **23.06.2025**.
3. **Projekt – vendim:** "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6 %, për muajin Qershor 2025.
4. **Projekt – vendim:** "Për miratimin e Tavanëve Përfundimtare të Shpenzimeve të Buxhetit Afatmesëm Vendor 2026-2028 të Bashkisë Fier".
5. **Projekt – vendim:** "Për emërtimin e shkollave të bashkuara "Jovan Ndreko" dhe "Dino Ismaili".
6. **Projekt – vendim:** "Për trajtimin me ndihmë financiare të familjes së shtetasit Petrit Bregu, fshati Lalar, Njësia Administrative Portëz, i dëmtuar nga zjarri i datës 12.06.2025.
7. **Projekt – vendim:** "Për miratimin e kërkesës së shoqërisë "Veko" sh.p.k. për dhënien e të drejtës së kalimit "Për ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e linjës nëntokësore së transmetimit të energjisë elektrike" në pronat e Bashkisë Fier"
8. **Projekt – vendim:** "Për miratimin e shpenzimeve për dhënien e ndihmës së menjëhershme financiare Znj. Juella Meta".
9. Diskutime dhe komente.

MBLEDHJET E KOMISIONEVE

1. **Komisioni Përgjegjës** për pikën **nr. 3 dhe 7** të rendit të ditës : Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, Drejtave të Njeriut, Infrastrukturës dhe Strehimit
2. **Komisioni Përgjegjës** për pikat **nr.4 dhe 7** të rendit të ditës : Komisioni i Ekonomisë Vendore, Financave, Buxhetit, Taksave, Tarifave, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare,
3. **Komisioni Përgjegjës** për pikat **nr.5** të rendit të ditës : Komisioni i Arsmi, Sporteve, Kulturës, Trashgimisë ,Kulturore, Turizmit, dhënies së Titujve , Emërtimeve, Marrdhënieve me Jashtë dhe Untegrimin European.
4. **Komisioni Përgjegjës** për pikën **nr.6** të rendit të ditës : Komisioni i Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Rehabilitimit.

Kryetar Këshilli

Antoneta Çunaj

